



Tirane, me 06/03/2018

## AKT THEMELIMI

### I SHOQERISE TREGTARE “ALBANIAN SERVICE PROVIDER” sh.p.k

Mbeshtetur në Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise, ne ligjiet:

- Nr. 9901 date 14.04.2008 , “ Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”;
- Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;

dhe formalitetet qe duhet respektuar nga Shoqerite Tregtare, me vullnetin e te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ne ortaket :

**-ZNJ. KRISELA NERANXI**, atesia Nikollaq, e datelindjes 24/05/1987, lindur ne Pogradec dhe banuese ne Tirane, me shtetesi shqiptare, e njohur prej meje noteres, mbajtese e leternjoftimit personal me Nr. 032750873 dhe me numer personal I75524043F.

krijojme shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar “**ALBANIAN SERVICE PROVIDER**” sh.p.k me akt themelimi si me poshte vijon :

#### Formimi

##### Neni 1

Sot, me date 06/03/2018, formohet shoqeria tregtare private e quajtur “**ALBANIAN SERVICE PROVIDER**” (Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar). Shoqeria do t’i nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do t’i nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Emri tregtar i shoqerise do te jete “**ALBANIAN SERVICE PROVIDER**” sh. P. k .

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

#### Selia e Shoqerise

##### Neni 2

Shoqeria “**ALBANIAN SERVICE PROVIDER**” sh.p.k. ka si qender te veprimtarise se saj qytetin e Tiranës. Adresa e saj eshte **Komuna Fark, Rruga “Peti”, Pallati “Sag” shpk, kati i pare, Fark-Tirane** Ajo e zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Rrepublikes se Shqiperise. Selia ligjore e saj eshte dhe selia e organeve drejtuese te saj.



## Objekti i Veprimtarise

Neni 3

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine si me poshte:

- Kembim Valutor;
- Agjent transferimi parash;
- Agjensi turistike.
- Gjithashtu, shoqeria mund te kryeje cdo lloj aktiviteti tjeter ekonomik, tregtar, financiar qe gjykohet i dobishem dhe i nevojshem per realizimin e objektit te shoqerise, te japi dhe te marri me qera, te hyje garant, te hipotekojë si dhe te marri pjese ne shoqeri te tjera.
- Se fundi, shoqeria mund te kryeje cdo operacion tregtar, shitblerje te pasurive te lujtshme apo te palujtshme, ipotekime, financiare dhe kreditimi, te japi garanci reale dhe personale per te tretet, te bleje, shesi ose marre me qera ndermarrje, dege ndermarrjesh, si dhe te marri interesa dhe te marri pjese ne shoqeri, ente, konsorce te themeluara ose duke themeluar me objekt te njejte ose te afert me qellim te realizoje objektin e shoqerise.
- Dhe ne pergjithesi, Shoqeria mund te kryeje veprimtari te tjera te nevojshme ose te dobishme per realizimin e objektit te shoqerise.
- Shoqeria mund te kryeje te gjitha operacionet mbi pasurit e lujtshme dhe te palujtshme, financiare, tregtare, te lidhi kontrata bilaterale aktive dhe pasive me Institute Krediti te autorizuar nga ligji edhe me firma private, te japi garanzi reale per te tretet dhe gjithcka qe eshte e nevojshme per arritjen e qellimit te shoqerise.
- Shoqeria mund te zhvilloje cdo aktivitet tjeter qe eshte i nevojshme per realizimin e objektit te shoqerise.

Per te vetmin qellim te arritjes se objektit te lartpermendur, shoqeria mund te bleje interesa, aksione, pjesemarrje te kapitalit, ne shoqeri te tjera, konsorciume ose kompani te cilat kane objekte te ngjashme apo analoge me te vetin dhe te kryeje te gjitha veprimet komerciale, industrial dhe financiare.

Ne vecanti, shoqeria, mund te marre ne pronesi, uzufukt ose me qera, kompani ose dege kompanish qe operojne ne fushen e nje ose me shume prej veprimtarive te mesiperme. Shoqeria mund te jape gjithashtu garanci, garanci mbi kredite dhe depozitat, te lere peng te mira dhe vlere te tundeshme, te vendose garanci hipotekore mbi te mirat e patundeshme dhe

te tundeshme te regjistruara dhe te vendose ne pergjithesi cdo garanci te mundeshme reale dhe personale. Te njejtat garanci mund te vihen dhe ne interes te subjekteve te lidhura me te nga raporte ekonomike ose pjesemarrje, me perjashtim te te tjereve. Shoqeria mund te tregetoje artikuj industrial, kancelari etj; Te Hape dhe menaxhoje bare, restorante, fastfood, pasticeri etj.

### Kohezgjatja e Shoqerise

#### Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pa caktuar me shume se 10-vjecar . Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe perfardo lloj shkaku me ane te vendimit te asamblese se ortakeve.

### Kapitali I Shoqerise

#### Neni 5

Kapitali i shoqerise eshte 1 500 000 (nje milion peseqinde mije) Leke i marre persiper dhe i nenshkruar nga ortaket.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 (nje) kuote me vlere nominale 1 500 000 (nje milion peseqinde mije) Leke, e cila perben 100% te kapitalit themeltar i shoqerise; Te cilat zoterohen nga ortaku si me poshte :

Ortaku	Kuotat e Nenshkruara	Vlera ne Leke	Perqindja(%)
KRISELA NERANXI	1	1 500 000	100
<b>Total</b>	<b>1</b>	<b>1 500 000</b>	<b>100</b>

Kapitali themeltar eshte vetem ne monedhen vendase, lek.

### Asambleja e Ortakeve

#### Neni 6

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte marrjes se vendimeve ne shoqeri. Ky organ perbehet nga ortaket themelues te kompanise. Ajo emerone ose shkarkone administratorin e shoqerise dhe administrator te tjere te vlerave materiale si dhe likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake

### Administratori

#### Neni 7

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar administrohet ne veprimatrine e saj te perditeshem nga **ZNJ. KRISELA NERANXI**, e cila vepron si administrator ne respektim te legjislacionit perkates.

Administratori kryen gjate veprimterise se tij ato detyra qe ai i gjykon te nevojshme qe jane ne interes te shoqerise per realizimin e objektivit te shoqerise dhe sigurimit te fitimit. Te drejtat, detyrimet dhe kufizimet e administratorit jane pershkruar ne statutin e shoqeriss.

Administratori nuk mund te kryeje vetem ato kompetenca qe jane percaktuar si ekskluzive te Asamblese se Ortakev  
Ne veprimatrine e tij administratori eshte i detyruar te dokumentoje hollesisht veprimtarine.

### **Veprimtaria Ekonomiko-Financiar**

#### **Neni 8**

Ne marredhenie financiare shoqeria vepron me monedhen vendase, Lek. Ajo ka te drejte te perdore edhe valuten e huaj konform legjislacionit ne fuqi.

Veprimtaria ekonomiko financiare e shoqerise mbyllet ne daten 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik, pervec rasteve urdhrave te vecante qe jepen nga asambleja e ortakeve. Ne fund te periudhes ushtrimore nxiren pasqyrat e gjendjes financiare te shoqerise (bilanci) dhe rezultati ekonomik (fitim/humbja) bazuar ne rregullat e mbajtjes se se kontabilitetit nga shoqerite private te percaktuara nga organet kompetente te sistemit fiscal.

### **Fitimi/Humbja**

#### **Neni 9**

Fitimi, percaktimi dhe miratimi i tij behet nga asambleja e cila pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te egzistences se tij percakton dhe pjesen e sejcilit. Fitimi qe do te shperndahet, perbehet nga fitimi i vitit financiar te cilit i jane zbritur shumat per rezervat e nevojshme si dhe i jane zbritur ose shtuar humbje/fitimet e mbartura nga vitet e mepareshme. Te punesuarit nuk marin pjese ne ndarjen e fitimit dhe nuk eshte e nevojshme te informohen per madhesine e tij.

Akti i themelimit u perpilua ne 3 (tre) kopje me vlere te barabarte, per t'ju shperndare organeve kompetente, ortakeve dhe mbajtje ne dokumentacionin baze te shoqerise "ALBANIAN SERVICE PROVIDER" sh.p.k

---


---

**Themeluesi i shoqerise tregtare "ALBANIAN SERVICE PROVIDER" sh.p.k**

ZNJ. KRISELA NERANXI

*Krisela Neranxi*

---



**VERTETIM NENSHKRIMI**

Sot, me date 06-03-2018 (dymije e tetembehjete) ne zyren e Noterise Tirane para meje noteres Maria M. Dano, me seli ne Tirane, rruga Kont Urani, u paraqit personalisht

-ZNJ. KRISELA NERANXI, atesia Nikollaq, e datelindjes 24/05/1987, lindur ne Pogradec dhe banuese ne Tirane, me shtetesi shqiptare, e njohur prej meje noteres, mbajtese e leternjoftimit personal me Nr. 032750873 dhe me numer personal 175524043F.

*E cila me deklaroi se;*

**KA NENSHKRUAR RREGULLISHT "AKT THEMELIMI-N E SHOQERISE ALBANIAN SERVICE PROVIDER" BASHKENGJITUR.**

Vertetimi i dokumentit u be ne baze te nenit 56 te ligjit 7829 date 01-06-1994 "Per Noterine" (I ndryshuar dhe udhezimit te Ministrit te Drejtesise Nr. 6921 date 17-08-2005.

NOTER  
Maria M. Dano

*Noter Maria M. Dano  
Nr. apt 4329062010  
Kont Urani, 39-Tirane*

